

## Përvoja e personave me kufizime nga pjesëmarrja në procesin zgjedhor në Maqedoni

- Raport nga fokus grupet e realizuara -

### Hyrje

Pas përfundimit të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare që u mbajtën më 11 dhjetor 2016, ekipi i projektit të “Hapni dritaret” realizoi katër fokus grupe me personat me tip të ndryshëm të kufizimeve: kufizime intelektuale, të dëgjuarit e dëmtuar, shikim i dëmtuar dhe kufizime trupore. Qëllimi i këtij mini-hulumtimi ishte të fitohen informata për përvojat e personave me kufizime lidhur me pjesëmarrjen e tyre në procesin zgjedhor, si dhe të përmbledhen mendimet e tyre për përmirësimin e mundshëm të inkluzivitetit në zgjedhje.

Përmes fokus grupeve u përfshinë 28 persona, prej të cilëve 13 ishin të gjinisë femërore dhe 15 të gjinisë mashkullore. Moshja e pjesëmarrësve ishte prej 18 deri 33 vjet. Katër fokus grupe u realizuan në Shkup. Mënyra e realizimit të fokus grupeve ishte e adaptuar ndaj nevojave të pjesëmarrësve. Për shembull, për grupin me personat me të dëgjuar të dëmtuar ishte angazhuar interpretues në gjuhën e shenjave.

Mini-hulumtimi është pjesë e projektit “Vota ime numërohet”, e financuar nga programi Civika Mobilitas, qëllimi i të cilës është të përmirësohet inkluziviteti i procesit zgjedhor në Maqedoni.

Organizimin e fokus grupeve e përgatitën dhe e realizuan bashkëpunëtorët përgjegjës Magdalena Dimkova Velevska dhe Marija Velinovska, të cilët e përgatitën këtë raport.

### Gjetjet dhe përfundimet nga fokus grupet e realizuara

#### I. Përvoja paraprake lidhur me proceset zgjedhore

A keni votuar deri tani?

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve të të gjitha katër grupet kanë përvojë në procesin e votimit dhe paraprakisht kanë marrë pjesë në proceset zgjedhore.

Si përjashtim, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve me të dëgjuarit e dëmtuar janë të rinj dhe për herë të parë e kanë fituar të drejtën për të votuar ose e kanë realizuar të drejtën e tyre në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në dhjetor të vitit 2016.

Për ata që kanë votuar:

Si kaluat në votimin paraprak? A u ballafaquat me ndonjë vështirësi? A Ju ndihmoi dikush gjatë votimit? Si zgjodhët për kë do votoni? Zgjedhja për kë do votoni a ishte zgjedhja Juaj personale?

Pjesëmarrësit e fokus grupeve kanë përvoja relativisht pozitive lidhur me pjesëmarrjen në proceset paraprake zgjedhore në vend: Prindërit e tyre shpesh janë personat të cilët u japin mbështetje, u ndihmojnë t'i kuptojnë informatat e nevojshme dhe ua sqarojnë procesin e votimit. Të gjithë pjesëmarrësit theksuan se vendimi për kë do ta japin votën e tyre në proceset paraprake zgjedhore ka qenë personal.

Megjithatë, edhe krahas asaj që pjesa më e madhe e pjesëmarrësve kanë votuar më parë, pjesa më e madhe i përmendën edhe vështirësitë me të cilat janë ballafaquar:

Personat me kufizime trupore theksuan se rregullisht ballafaqohen me probleme të njëjta ose të ngjashme, të cilat nuk tejkalohen gjatë kohës: jo qasje fizike e vendvotimeve, vendosja e paravanëve fizik dhe kutive për votim kërkojnë gjatë votimit ose gjatë hedhjes së fletëvotimeve në kuti të qëndrosh në këmbë etj.

Për ilustrim, një nga pjesëmarrësit ka theksuar: “E kam të vështirë të qëndroj në këmbë dhe të votoj, jam më stabil kur ulem, kam më pak dridhje”.

Një grua e re e cila përdor karrocë invalidore tha se “Edhe pse e kam vendin e përshtatur për votim si shfrytëzuese e karrocës, kam vështirësi kur duhet fletëvotimin ta hedh në kutinë për votim, pasi që ajo është e vendosur në lartësi jo adekuate”.

Personat të cilët përdorin karrocë invalidore thonë se kur zgjedhjet zhvillohen gjatë dimrit kanë vështirësi me lëvizshmërinë: “Nëse është ftohtë ose ka borë, e kam të vështirë ta shtyjë karrocën”.

Personat me shikim të tërësishëm të dëmtuar e theksuan brengën e tyre për votën adekuate të shënuar: “Personi i verbër voton me shoqërues dhe jo gjithmonë jemi të sigurt se shoqëruesi e ka rrethuar zgjedhjen tonë”.

Për ata të cilët nuk kanë votuar:

Cili ka qenë shkaku pse nuk kanë votuar?

Pjesëmarrësit të cilët nuk kanë votuar në zgjedhjet paraprake, një pjesë më e vogël e numrit të përgjithshëm, nuk i përmendën shkaqet për mos votimin, të cilat janë të lidhura me kufizimin e tyre.

## II. Përvoja gjatë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare 2016

### A votuat në zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2016?

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në të gjitha katër fokuset grupet theksuan se kanë votuar në zgjedhjet të cilat u mbajtën më 11 dhjetor 2016.

Një nga pjesëmarrësit me shikim të dëmtuar tha se nuk i është mundur të votojë në vendvotim, pasi që kur ka shkruar të votojë nuk kanë mundur ta gjejnë në listën zgjedhore, edhe pse paraprakisht e ka kontrolluar në ueb faqe të Komisionit shtetëror zgjedhor dhe ka qenë në listë.

Për ata të cilët kanë votuar:

Si kaluar gjatë votimit? A u ballafaquat me ndonjë vështirësi? A Ju ndihmoi dikush gjatë votimit? Zgjedhja juaj për kë votuar e ishte e Juaja personale? Si vendostë për kë do votoni?

Pjesëmarrësit me kufizime intelektuale të cilët kanë votuar ishin të vetmit të cilët theksuan se nuk kanë hasur në vështirësi më të mëdha gjatë votimit. E kanë ditur lehtë se në cilën mënyrë ta japin votën e tyre për shkak se në fletëvotimet gjenden simbolet e partive: “Ishte e lehtë pasi që kishte simbole të partisë”.

Pjesëmarrësit tjerë të cilët kanë votuar janë ballafaquar me vështirësi gjatë votimit:

Pjesëmarrësit me kufizime trupore theksuan disa vështirësi gjatë qasjes deri te vendvotimi: “Klasa ku duhej të votoj gjendej në katin e parë dhe nëna ime duhej të më nxjerrë nga karroca dhe me ndihmën e saj të arrij deri te vendvotimi”.

Vështirësi tjetër është lidhur me vetë procesin e votimit, kryesisht lidhur me lartësinë e paravanit zgjedhor dhe nevoja që të qëndrojnë në këmbë gjatë regjistrimit të votuesve dhe vetë votimi. Po ashtu një nga pjesëmarrësit ka vërejtur “Marr stilolaps me vete nga shtëpia, pasi që nuk mund ta tërheq”.

Hedhja e fletëvotimit në kuti për personat të cilët përdorin karrocë invalide është po ashtu vështirësi – kutia është e vendosur mjaft lartë dhe ata nuk mundën vetë ta bëjnë këtë dhe duhet të kërkojnë ndihmë nga persona tjerë që ta bëjnë këtë për ata.

Pjesëmarrësit me shikim pjesërisht të dëmtuar theksuan se kanë vështirësi që t'i vërejnë të gjitha numrat dhe tekstin në listën zgjedhore: “Nuk jam i sigurt se e rrethova numrin që ishte zgjedhja ime, pasi që fonti ishte shumë i vogël”.

Një pjesëmarrës me shikim të dëmtuar të plotë tha se në vendvotimin ku ai ka votuar, komisioni dhe këshilli nuk kanë qenë të informuar sa duhet për mënyrën e votimit nga ana e personit me shikim të dëmtuar: “Këshilli në klasë nuk ishte i informuar sa duhet për rregullën si voton personi me shoqërues”.

Pjesëmarrësit me dëgjim të dëmtuar u ankuan se procesin e votimit nuk e kanë pasur tërësisht të qartë: “Pak isha i hutuar”. Më shpesh informatat lidhur me votimin i kanë marrë nga prindërit e tyre, por jo nuk ka qenë gjithmonë e mjaftueshme: “Unë isha me prindërit e mi dhe shihja si bëjnë ata. Diçka më dhanë, e më kërkuan, jo kjo dorë, këtë, isha pak i hutuar”. Personat me dëgjim të dëmtuar thanë se nuk i kanë parë në televizion sqarimet për procesin e votimit me interpretues në gjuhën e shenjave në televizion. Megjithatë, duhet të theksohet se pjesa më e madhe e personave të inkuadruar me dëgjim të dëmtuar ishin mjaft të rinj dhe pjesa më e madhe prej tyre këtë vit janë bërë të moshës madhore dhe për herë të parë kanë marrë pjesë në zgjedhje.

**Për ata të cilët nuk kanë votuar:**

**Cili ishte shkaku pse nuk keni votuar?**

Një pjesë e pjesëmarrësve nga fokuset grupet deklaruan se nuk kanë votuar në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në dhjetor të vitit 2016.

Një vajzë me kufizime trupore tha se nuk ka qenë në mundësi të votojë për shkaqe personale.

Një djalë i ri me shikim pjesërisht të dëmtuar tha se nuk ka arritur të votojë pasi që nuk ka qenë në listën zgjedhore edhe pse paraprakisht gjendej në listën e shpallur në ueb faqen e Komisionit Shtetëror Zgjedhor. Ai dyshon se bashkëpunimi i tij me përfaqësues të lartë nga opozita, në kuadër të shoqatës së qytetarëve ku është anëtar, ka qenë shkaku që nuk gjendej në listën zgjedhore në vendvotim.

Një vajzë me kufizime intelektuale nuk ka qenë e motivuar të votojë: “Vitin e kaluar votova, por kot – asgjë nuk ndryshoi”.

Disa persona me dëgjim të dëmtuar të cilët nuk kanë votuar, nuk besojnë se me votën e tyre mund të ndryshojnë diçka dhe nuk e kanë pasur të rëndësishme të votojnë: “Edhe kështu edhe ashtu shumica vendos”, “Njëlluj, asgjë nuk do ndryshoj”.

**A kishit mundësi të kuptoni çfarë ka në programet e partive politike? Kush ju tha? Në cilën mënyrë vendosët për kë do votoni?**

Lidhur me ofertat e partive politike, pjesëmarrësit e fokus grupeve theksojnë se shumë shpesh deri te informatat për përpjekjet partiake vijnë përmes televizionit dhe internetit. Ato u ndihmojnë të vendosin për kë do ta japin votën e tyre. Por vërejnë edhe se informatat të cilat i ndajnë në televizion ose në materialet e shkruara shpesh janë të paqarta dhe të pakuptueshme.

Lidhur me programet e partive politike, pjesëmarrësit me kufizime intelektuale theksuan se deri tani nuk kanë hasur program i cili lehtë mund të lexohet. Shoqata ku janë anëtarë u ka ndihmuar t'i shqyrtojnë programet dhe ua kanë sqaruar përpjekjet partiake në përgjithësi, jo vetëm ato që kanë të bëjnë me kufizimet. “Mua më intereson i gjithë programi, jo vetëm pjesa për personat me kufizime.”

Asnjë nga pjesëmarrësit me shikim të dëmtuar dhe me të dëgjuarit e dëmtuar nuk kanë lexuar asnjë nga programet e partive politike: “Në shtëpi e pash, por materiali nuk ishte i kuptueshëm”, “Tekstet nuk janë mjaft të kuptueshme, edhe pse i kemi të kapshme në kompjuter”.

Personat me dëgjim të dëmtuar theksuan se rrallë mund të inkuadrojnë interpretues në gjuhën e shenjave në ndonjë nga emisionet, ku janë prezantuar programet e partive politike ose diskutohet për atë çfarë na ofrojnë.

Të gjithë pjesëmarrësit vendosin ta japin votën e tyre në zgjedhje në bazë të informatave për programet partiake. Një djalë i ri me kufizime trupore e ilustron këtë: “E përcjell se kush ka plan më të mirë për jetë në Maqedoni”.

### A jeni aktiv në politikë?

Pothuaj asnjë pjesëmarrës nuk është aktiv në politikë, e as nuk është anëtar në ndonjë parti politike.

Si përjashtim, një person me dëgjim të dëmtuar theksoi se ka marrë pjesë në mitingje të një partie politike në shumë qytete pasi që “e kanë thërritur” edhe pse nuk është anëtar i partisë. Dy pjesëmarrës me kufizime intelektuale thanë se janë anëtarë të partisë politike, por me nënshkrimin e fletë anëtarësimi nuk kanë qenë aktiv edhe pse kanë marrë ftesa për mbledhje dhe mitingje.

### Pse nuk jeni pjesë e ndonjë partie politike?

Një pjesë e pjesëmarrësve deklaruan se për momentin nuk kanë interesim të jenë pjesë e ndonjë partie politike, por nuk e përjashtojnë mundësinë që të ardhmen të jenë.

Një pjesë e pjesëmarrësve kanë vështirësi të marrin informata ku i kanë zyrat partitë politike: “Por ne nuk e dimë ku i kanë partitë që të shkojmë; Kur do të dinim ku janë, do të shkonim dhe do të bisedonim”. Një pjesë i cekin vështirësitë që t’u qasen zyrave të partive; “Nuk mund të jemi aktiv, pasi që zyrat e partive janë pa qasje, një pjesë janë në katin e dytë, ndera nuk ka ashensor”.

Një pjesëmarrës me shikim të dëmtuar tha se për shkak të përvojës së mëparshme, nuk dëshiron përsëri të jetë pjesë e ndonjë partie politike: “Unë kam qenë aktiv, por kuptova se vetëm dëshirojnë t’i mbledhin votat tona dhe pastaj asgjë mos bëjnë për ne”.

### Çfarë mendoni se partitë politike duhet ta marrin parasysh kur komunikojnë me personat me kufizime/kur kërkojnë mbështetës/votues me kufizime?

Pjesëmarrësit e fokus grupeve thonë se para së gjithash partitë politike duhet të kontaktojnë me ata, drejtpërdrejt t’i pyesin se çfarë ju nevojitet, t’i inkuadrojnë në procesin e planifikimit dhe përpunimit të programeve dhe t’i plotësojnë premtimet.

Pjesëmarrësit me kufizime trupore i porositin partitë politike: “Të kenë durim që të na “dëgjojnë”, “Të mos na shohin si numra, por si personalitete të cilat mund ta japin kontributin e tyre në shoqëri”.

Pjesëmarrësit me dëgjim të dëmtuar porositin: “Është e rëndësishme që çdo parti ta paraqesë atë që e ofron”, “Të gjithë partitë të kenë përkthim që vetë të vendos” dhe “Së pari ta dinë gjuhën e shenjave”.

Pjesëmarrësit me kufizime intelektuale theksuan se partitë politike duhet t’i plotësojnë premtimet si “Të na punësojnë”, “Të na japin kartela për transport publik”, “T’i plotësojnë punët që i premtojnë”, “Tu thuhet partive të mos harrojnë se diçka do të bëjnë dhe pastaj të mos e plotësojnë”. Ata po ashtu e theksojnë nevojën që partitë politike më shpesh të realizojnë takime me ata.

## Rekomandime për përmirësimin e inkluzivitetit të procesit zgjedhor

Pjesëmarrësit e fokus grupeve kanë mundësi vetë të propozojnë zgjidhje dhe përmirësime të mundshme të inkluzivitetit të procesit zgjedhor dhe vetë votimi:

<b>Në cilën mënyrë vetë procesi zgjedhor dhe votimi mund të përmirësohen?</b>			
<b>Rekomandim i përgjithshëm</b>			
Institucionet dhe partitë politike të vendosin praktikë të komunikimit të drejtpërdrejtë dhe konsultime me personat me kufizime për të gjitha çështjet shoqërore, e veçanërisht për çështje me interes të veçantë për personat me kufizime. Në të vërtetë, sipas motos së Konventës për të drejtat e personave me kufizime – “Asgjë për ne pa ne”.			
<b>Rekomandime deri te Komisioni shtetëror zgjedhor dhe institucionet tjera kompetente publike</b>			
<b>Persona me kufizime trupore</b>	<b>Persona me të dëmtim të shikimit</b>	<b>Persona me dëmtim të dëgjuarit</b>	<b>Persona me kufizime intelektuale</b>
Të sigurohet qasje e plotë fizike në vendvotimet	Të sigurohen fletëvotime me relief me font më të madh	Të sigurohen sqarime dhe informata për votimin në gjuhën e shenjave	Të propozojë përdorimin e simboleve të partive politike në fletëvotime
Të sigurohet qasje deri te paravanët votues	Të sigurohen fletëvotime të shkruara në Alfabetin e Brajrit	Të sigurohen informata për rezultatet nga votimi në gjuhën e shenjave	Të përdoren fotografi të kandidatëve në fletëvotime
Stilolapsat te paravani votues të jenë të siguruar me pe më të gjatë	Regjistrimi i votuesve të verbër në vendvotim të bëhet me faksimil ose gjurmë elektronike		
Kutitë për votim të vendosen në lartësi adekuate për personat të cilët përdorin karrocë invalide	Fletëvotimi të jetë i kapshëm në formë elektronike në internet		
Të vendoset sistem për votim elektronik	Të përdoren makina speciale për votim me kufje		
	Këshillat votues të njoftohen hollësisht me procedurat e votimit të personit me shoqërues		
<b>Rekomandime deri te partitë politike</b>			
<b>Persona me kufizime trupore</b>	<b>Persona me dëmtime të shikimit</b>	<b>Persona me dëmtime të dëgjimit</b>	<b>Persona me kufizime intelektuale</b>
Qasje e plotë fizike te zyrat partiake	Të sigurohen materiale zgjedhore partiake me font më të madh dhe me Alfabetin e Brajrit	Të shfrytëzohen interpretues në gjuhën e shenjave gjatë pjesëmarrjes në media dhe komunikim i drejtpërdrejtë me votuesit	Të prezantohen përpjekjet partiake përmes materialeve që lexohen lehtë (easy to read)

Shkup, dhjetor 2016

Magdalena Dimkova Velevska  
 Marija Velinovska  
 Vladimir Llazovski